



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM SHKODËR

Nr. 1613/7 Prot

Shkodër, me dt. 31.10.2023

NJOFTIM

L ë n d a: Njoftim mbi rezultatet e verifikimit paraparak për lëvizje paralele në kategorinë drejtuese, pozicioni “*Shef Sektori, në Sektorin Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve*”.

KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Bazuar në ligjin nr. 98/2016 “Për Organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, Vendimit nr. nr.622, datë 10.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, Udhëzimit nr.85, datë 11.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, Shkresës nr. 1614 prot, datë 10.10.2023, për shpalljen e procedurës së lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil gjyqësor, për kategorinë drejtuese, për pozicionin: **1 (një) pozicion** – “*Shef Sektori, në Sektorin Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve*” pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, kategoria e ulët drejtuese III-2, ju njoftoj :

Në përfundim të vlerësimit të Këshillit të Gjykatës, në lidhje me procedurën e lëvizjes paralele në kategorinë drejtuese, në pozicionin “*Shef Sektori, në Sektorin Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve*”, ku u vlerësuan dy kandidatë të reflektuar në njoftimin nr 1613/4prot datë 26.10.2023 të cilët u vlerësuan në më pak se 70 pikë dhe në të tilla kushte u skualifikuan

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër do të vijojë me procedurat e ngritjes në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor, për pozicionin drejtues “*Shef Sektori, në Sektorin Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve*”, sipas përcaktimeve dhe afateve të përkrahura në Shpalljen nr. 1613 prot, datë 10.10.2023.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin!

